

Udhëzime për krijimin e regjistrimeve testuese

Një nga kushtet për marrjen e lejes për katalogimin e përbashkët në sistemin COBISS.AL është praktika në mjedisin testues, ku kataloguesi krijon regjistrime bibliografike testuese për botimet monografike (libra) dhe pas këtyre të fundit, krijon edhe regjistrime të tjera për lloje të veçanta materialesh (burime në vazhdim, artikuj, materiale jolibra, materiale antikuarësh). Përveç regjistrimeve bibliografike, kataloguesi krijon gjithashtu edhe regjistrimet korresponduese të termave të njësuar për emrat personal (vetjak) të autorëve.

• Rregullat dhe standardet

Për krijimin e regjistrimeve testuese (bibliografike dhe të termave të njësuar) kataloguesi është i detyruar të zbatojë rregullat dhe standardet me të cilat ai është njohur gjatë trajnimeve si më poshtë:

- Përshkrimi bibliografik i materialeve bibliotekare. - Tiranë, 2001
- Klasifikimi dhjetor universal (Shtojcat e ndryshimeve). - Tiranë, 1991
- ISBD (G): Standardi Ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik (i përgjithshëm): ribotim 2004. – Maribor, 2010
- ISBD (M): Standardi Ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik për botimet monografike : ribotim 2002. – Maribor, 2010
- ISBD (ER): Standardi Ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik për burimet elektronike: ripunim i ISBD(CF) – Standardi Ndërkombëtar i Përshkrimit për Skedarët e kompjuterit. – Maribor, 2010
- Udhëzime për zbatimin e ISBD-ve në përshkrimin e Pjesëve Përbërëse. – Maribor, 2010
- ISBD (CR): Standardi Ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik për serialet dhe burimet e tjera në vazhdim: rishikuar nga ISBD(S) – Standardi Ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik për Serialet: ripunim 2002. – Maribor, 2010
- ISBD (NBM): Standardi Ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik për materialet jo-libra: botim i ripunuar. – Maribor, 2010
- Form and Structure of Corporate Headings. – London : IFLA International Office for UBC, 1980. — x, 15 p. + Amendment sheet, pertaining to Rules 29-34 on Religious Bodies, August 1982.
- Guidelines for authority records and references. – 2nd ed. – München, 2001 (<http://archive.ifla.org/VII/s13/garr/garr.pdf>)
- Guidelines for Subject Access in National Bibliographies. - Berlin/Munich: De Gruyter Saur, 2012 (ky material gjendet online në versionin draft, 2011 në linkun : http://www.ifla.org/files/classification-and-indexing/subject-access-by-national-bibliographic-agencies/nba_guidelines_draft_2011-05.pdf)
- Formati COMARC/B për të dhënat bibliografike

- Formati COMARC/A për të dhënat e njësuara
- Formati COMARC/H për të dhënat e koleksioneve
- COBISS3/Katalogimi

Përveç njohjes së rregullave të katalogimit dhe formateve, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet saktësisë së regjistrimit të të dhënave të cilat gjenden në botim, duke marrë gjithashtu në konsideratë edhe rregullat drejtshkrimore dhe rregullat e përdorimit të shkronjave kapitale në katalogim.

Shpesh gabimet në regjistrime ndodhin për shkak të shtypjes, futjes jo të saktë të të dhënave në fusha, të dhëna keto të cilat duhet të përputhen me njera-tjetrën, apo që duhen vendosur ndryshe ose mungojnë etj.

- **Numri i regjistrimeve, identifikimi i regjistrimeve testuese dhe adresa e dorëzimit të tyre**

Kataloguesit mund të krijojnë regjistrime testuese gjatë trajnimit, por për verifikim duhet të dorëzojnë vetëm 30 regjistrime për monografitë dhe 10 regjistrime për artikujt, botimet në seri, materialet jolibra dhe antikuarë.

Kataloguesit duhet të njoftojnë mbi krijimin e regjistrimeve testuese të dërguara veç e veç për secilin lloj të materialit në adresën lejet@al.cobiss.net. Regjistrimet për verifikim duhet të kenë në nëfushën 992b kodin unik (i cili nevojitet për kërkim), i cili duhet të dërgohet me postë elektronike (i shkruajtur edhe në Subjekt) në këtë formë:

<Kodi i lejes>, <Emri dhe Mbiemri i kandidatit>, 992b=<kodi>, regjistrimet testuese

(Shembull: A, Agron Spahiu, 992b=xxxx, regjistrimet testuese)

- **Shumëllojshmëria e regjistrimeve testuese**

Kataloguesi duhet të krijojë regjistrime për monografi të ndryshme. Midis shembujve duhet të përfshihen:

- vepra me autorë parësor individual midis të cilave është i detyrueshëm klasifikimi i botimeve të vecanta ose vepra të zgjedhura të një autori, gjithashtu mundet edhe fjalorë të të njëjtit autor, leksikë, komente dominuese të autorëve në akte ligjesh, leksione të publikuara, monografi të arteve të bukura, kur përmbajnë kryesisht veprën artistike të artistit, si edhe vepra të tjera, të cilat sipas rregullave të katalogimit qëndrojnë në grupin e veprave me autorë individualë parësor (maksimumi 20 regjistrime);
- vepra me autorë kolektiv parësor, midis të cilave janë të detyrueshme përmbledhje punimesh të konferencave, mbledhjeve/takimeve etj. (jo më pak se 3 regjistrime), si edhe vepra të cilat raportojnë punën e organizatave, raportet e tyre financiare, organizimet e tyre, lista çmimesh, statutet dhe rregullat e institucioneve (jo më pak se 2 regjistrime); mund të jenë edhe kushtetuta, ligje, njësi politiko-territoriale, si edhe vepra të tjera, të cilat sipas rregullave të katalogimit qëndrojnë në grupin e veprave me autorë kolektiv me përgjegjësi parësore;

- vepra me autor anonim, midis të cilave vepra që kanë më shumë se tre autorë, antologji letrare apo përmbledhje punimesh me autorë të ndryshëm (jo më pak se 2 regjistrime);
- njësi të cilat përmbajnë shumë pjesë të një autori, ose disa pjesë të autorëve të ndryshëm (jo më pak se 1 regjistrim);
- monografi me disa vëllime (jo më pak se 2 regjistrime).

• Duplikatet

Përpara se të krijoni regjistrime të reja është e domosdoshme të kontrollohet nëse në bazën testuese lokale dhe të përbashkët tashmë ekzistojnë botimet të cilat dëshirojmë t'i katalogojmë. Nëse regjistrimi ekziston, duhet të zgjidhni botime të tjera për katalogim.

Gjithashtu duhet të keni kujdes që nuk mund të krijoni dublikat në bazën e termave të njësuar për emrat vetjak.

Krijimi i një dublikati konsiderohet një nga gabimet më të mëdha që mund të bëjë një katalogues. Por gjatë kohës së vlerësimit të regjistrimeve për marrjen e lejes, krijimi i dublikateve nuk merret parasysh, dhe kandidati pas vlerësimit dhe vënies në dijeni për këto regjistrime dublikatë, duhet që në vend të dublikatëve të regjistrojë po aq regjistrime të reja sa dublikatë janë gjendur në regjistrimet e tij testuese.

Kataloguesve ne u rekomandojmë të krijojnë sa më shumë regjistrime të reja, të cilat nuk ndodhen në bazën COBISS.AL.

• Konsultime

Për konsultime dhe ndihmë ju mund të na kontaktoni në:

- adresën lejet@al.cobiss.net. Plotësoni Subjektin në formën e mëposhtme:
<Kodi i lejes>, <Emri dhe Mbiemri i kandidatit>, 992b=<kodi>, regjistrimet testuese
(Shembull: A, Albana Hoxha, 992b=xxxx, regjistrimet testuese) ose
- në numrat e telefonit:
mirlona.buzo@izum.si, tel.:00355 68 200 15 49
arjeta.sadiku@izum.si, tel.: 00386 2 2520 451